



PROCESVERBAL IV/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IV (katërt) për vitin 2022 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 15.03.2022
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësuesi i OSBE-së
Përfaqësuesi i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. hqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim - plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153;**
- 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për emërimin e komisionit për ndarjen e mirënjohjeve për “13 Qershorin”;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12176;**
- 7. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - mars 2022;**

8.Informatë për rastet e përgjithshme të dhunës në familje;

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit,dhe i njofton me rendin e ditës.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përshëndet të pranishmit.Desha të propozoj pikë shtesë në rend dite.Në Asamblenë e kalume është diskutu rreth pikës për hapjen e shqyrtimit publik për Hartat Zonale,e cila është miratu.Unë propozova që me u formu një grup punues prej përfaqësuesëve politikë që me qenë më afër pjesë e procesit të dokumenteve të planifikimit dhe jo vetëm hartave zonale,për arsye se asambleistat kanë më pak njohuri se si shkon ky proces dhe vendimin final e marrin vetë ata.

Kryesuesi - kërkon sqarime rreth punës së grupit punues.

Sanie Kuçi Rexhepaj - do të jenë vetëm pjesë e procesit.

Bulëza Kuçi - personalisht më pëlqen ideja e Sanies.

Sanie Kuçi Rexhepaj - nuk është ideja me monitoru në aspektin ligjor siq është procedura,por çështja është të jemi më afër të informun rreth punës se si është duke u zhvillu.

Urim Suka - e mbështes si ide një komision të tillë.Vetëm se,do të ishte mirë që kjo ide mu kan si lloj vendimi për me i ditë pak a shumë më mirë detalet.

Avni Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Është e vërtetë që Sania e ka ngrit mbledhjen e kalume këtë çështje,mirëpo në Asamble ka qenë që kjo gjë të jetë pak si kompetencë, si organ vendimmarrës ky komision,mirëpo megjithatë është në kundërshtim me ligjin për planifikim hapësinor dhe me udhëzimin administrativ. Anëtarët e Kuvendit janë përfaqësues të qytetarëve dhe shqyrtimet publike,pavarësisht a janë harata zonale apo janë akte tjera ligjore që miratohen nga Kuvendi,ata e kanë obligim që të marrin pjesë në diskutime publike dhe shqyrtime publike.Andaj mendoj dhe vlerësoj që ky komision edhe nëse themelohet nuk mund të ketë ndonjë efekt juridik që të ketë proces vendimmarrës,për arsye se çështja e këtij procesi të shqyrtimit është kompetencë e drejtorisë së urbanizmit në bashkëpunim me ekipin komunal për Hartat Zonale si dhe MAPL-në.

Sanie Kuçi Rexhepaj - diskutimet dhe shqyrtimet publike janë ftesa publike dhe secili asamblist ka të drejten me shku.Kurse këtë grup që e propozoj janë përfaqësues të partive politike që marrin pjesë edhe në takime që mbahen në nivel të Komunës.

Avni Bytyqi - kur të formohet një komision duhet mi ditë edhe detyrat dhe përgjegjësitë. Në këtë rast unë nuk po mund të kuptoj dhe vlerësoj se çfarë detyra mund ti japim këtij komisioni, për derisa nuk është organ vendimmarrës. Janë organet kompetente që kanë me u marrë me këtë çështje, por megjithatë mbetet në dorën tuaj.

Kryesuesi - sa e kupova, Sanija kërkon me pas organ monitorues.

Sanie Kuçi Rexhepaj - meqenëse sa i përket vendimmarrjes nuk kemi të drejtë, atëherë na takon monitorimi dhe njohja e procesit.

Avni Bytyqi - çështja e monitorimit, procesit të konsultimit publik për planifikim hapësinor është ekskluzivisht kompetencë e Ministrisë së Planifikimit Hapsinor, për arsye se drejtoria për urbanizëm e ka për obligim ta njoftojë në çdo hap apo proces MAPL-në me shqyrtime publike të dokumentave për planifikim hapësinor. Po ju njoftoj në mënyrë që të mos kthehet në rishqyrtim.

Urim Suka - unë e kuptoj Sanien. Për pjesën e Haratve Zonale skemi shumë njohuri. Një komision i tillë bëhet pjesë e procesit, marrin informata më shumë dhe neve si gr. i asamblastëve kur të vje puna për me vendos, jemi shumë ma mirë të informum.

Kryesuesi - kemi dhe një pikë shtesë, ku zyrtari ligjor financiar solli një vendim dhe po kërkon bartjen mjeteve nga fondi burimor (38) që është grant qeveritar rezervë për vitin 2022.

Fadil Hoxha - përshëndet të pranishmit. Ai thotë se kjo pikë është caktuar jashtë rendit të ditës për arsye se zyrtari që është përgjegjës për projektet kapitale dhe gjithë buxhetin tonë më ka dërgu shkresë për disa prej projekteve që nuk e kalojnë, dhe ka kërku specifikime për këto projekte. Ai përmend projektet dhe thotë se ka llogaritë që vetëm këto kanë me dal në rezerva. I kemi analizu më shumë dhe kom llogarit që edhe këto kanë me kalu sepse ka thënë se është në rregull. Por para se me pru në KPf më ka dërgu një shkresë tjetër që ka thënë: Fondi emergjent të shërbimet publike, të bujqësi-ngritja e serave, fondi emergjent për mbrojtjen e kulturave bujqësore, rregullimi dhe ndërtimi stallave për bagëti dhe ndërtimi dhe ngritja e kapacitetit dhe mekanizmit bujqësor për Komunën e Suharekës. Ata kanë thanë që këto mjete nuk mujm me i trajtu që i plotësojnë kriteret e projekte kapitale. Dhe pas takimit me ta, mua më kanë thënë që kështu është vendos në nivel të vendit, që këto projekte të bujqësisë i takojnë kategorisë së subvencioneve ose duhet me i qu në projekte të tjera, varësisht ku është nevoja dhe me i ridestinu. Andaj është vendos që këto projekte me kalu në ridestinime.

Urim Suka - edhe më herët e kemi diskutu që po na bini letra pa i trajtu më herët sepse nuk po dim qysh me dhanë verdiktin kryesor. Kur e keni miratu buxhetin unë ju kam thënë që spo dini me planifiku, keni planifiku keq, e ju as që jeni kujtu me dhanë përgjigje por veq e keni dhanë votën. E tash po vërehen që kanë dal probleme dhe unë paskam pas të drejtë. Ndërtimi i kolektorit në rrugën "Skënderbeu, dhe këtu thotë bujqësi. A lidhet me bujqësi kjo dhe a kemi të drejtë?

Fadil Hoxha - ky projekt është të shërbimet publike, por tash pasi është pjesë e bujqësisë del si projekt i ri. Realisht ky projekt ec dhe e përmbush rregulloren 04 dhe 06 si kriterium. Edhe projektet me bashkëfinancim janë, por unë skam mujt mi vendos të shërbimet publike.

Urim Suka - ju po thoni që ky projekt ekziston të shërbimet publike, atëherë pse po ja shtoni edhe 410 mijë euro. A duhet me ja shtu patjetër?

Fadil Hoxha - nuk e di. Ato janë propozimet tona, dhe të juajat janë me propozu ose mi hek.

Urim Suka - a ka nevojë mi shtu edhe 410 mijë?

Fadil Hoxha - unë kam propozu. Dhe a ka nevojë, për këtë jep sqarime Kryetari.

Kryesuesi - u planifiku faza e parë mu kry me atë pjesë. Dhe ju e dini që rruga Skënderbeu ka shumë probleme.

Liridon Fandaj - duhet me na ardh një sqarim se pse janë refuzu këto projekte dhe pse nuk janë destinu ato? Nëse bëhet ri-alokimi i mjeteve dhe i keni qu në këto projekte, atëherë duhet me ditë që mos ta qojmë edhe një herë dhe mu kthy prap.

Fadil Hoxha - këto janë pjesë e rezervave. Këto rezerva nëse nuk i bëjmë ri-destinim, këto shkojnë në suficit sepse nuk kanë emra. Emrat që ne i kemi dhënë nuk i kanë plotësu kriteret e projekteve kapitale.

Zyrtari kryesor financiar vazhdon më tej me sqarime.

Liridon Fandaj - nëse kemi ndonjë projekt tjetër që është në vazhdimësi, është ma mirë me shku në atë kategori sesa në këtë projekt që është i planifikum.

Fadil Hoxha - është i palnifikum aq,por po thuhet që ka nevojë më tepër shtesë.

Kryetari - vitin e kaluar ka qenë i njëjti rast.Ka dhjetë vite që nuk kemi punu me shtalla.Çdo vit kemi punu me sera.Kolektori kushton mbi 1 milion euro.Sa mjete kemi pas, ne kemi mendu me shku me faza.Në kornizë ka të parapame edhe për vitin 2023 dhe 2024.Në dy anët ka mu punu kanalizimi i ujërave të zeza,sepse të gjitha lokalet kanë probleme me vërshimet.Kryetari vazhdon më tej me sqarime dhe për projektet tjera.

Liridon Fandaj - unë e kam hallin që ne e qojmë si projekt,por e kthejnë prap.

Fadil Hoxha - këto mjete nëse ne nuk i destinojmë,këto mjete mbesin rezerva dhe nuk mund ti shfrytëzojmë për asgjë.Ju jepne një ide,sepse nuk do të thotë mi dërgu në këtë projekt.

Urim Suka - 469 mijë euro janë kanë të destinune për bujqësi,dhe këto pare pi hiqen bujqësisë dhe po shkojnë tjetër kund.A mund këto pare me mbet në bujqësi,por me projekte tjera?

Kryesuesi - këto pare janë në rezerva.

Urim Suka - por ministria nuk po thotë heki prej bujqësisë.Ne këtë pikë nuk e mbështesim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e parë shtesë,propozimin e Sanies.

**6 për, 1 apstenim
Miratohet**

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e dytë shtesë,për ri-alokimin e mjeteve brenda fondi burimor(38) Grandi Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2022.

**4 për, 3 kundër
Miratohet**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me dy pikat shtesë.

**4 për, 3 apstenime
Miratohet**

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e parë.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - prezanton pikën dhe thotë se i ka kryer të gjitha procedurat nga komisioni i kaluar,por për arsye të shpalljes së zgjedhjeve është ndërprerë dhe nuk ka përfunduar si proces.Kërkohet ta qojmë në Asamble për diskutim,që ta vazhdojmë ose me kthi në pikën zero.

Avni Bytyqi - ky proces ka përfunduar dhe nuk kthehet në pikën zero.Ka mbet çështja vetëm te Kuvendi me votu ose jo.

Liridon Fandaj - kërkoj interpretim ligjor.

Avni Bytyqi - vitin e kaluar para se mu shpall zgjedhjet ne kemi fillu një procedurë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike në Zonën Industriale në Shirokë.Komisioni ka punu dhe Kuvendi ka rekomanduar që këto parcela mi miratu dhe me ja dhan në shfrytëzim firmës "Bleta".Pasi e kemi mbajtur mbledhjen e KPF-së dhe e kemi procedu për Asamble,po atë ditë presidentja ka shpall zgjedhjet.Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës,neni 10 thotë: në moment kur presidenti i republikës shpall zgjedhjet,të gjitha procedurat e dhënie së pronës publike në shfrytëzim pezullohen deri në inaugurimin e organeve të reja.

Liridon Fandaj - nuk kam asgjë kundër asaj firme,po veq desha të di a është në rregull në aspektin ligjor,sepse kanë kalu 6 muaj.

Avni Bytyqi - në aspektin ligjor jemi në rregull.

Dardan Berisha - nëse i ka përfunduar të gjitha procedurat ligjore,unë jam pro vendimit.Por sipas planit rregullativ me destinim,nëse themi përpunimi i produkteve ushqimore,këtu e kam të kuart që duhet mi dhan ni term,që nëse do me bo fabrikë,por nëse i vyn ni plantacion është diçka tjetër.

Avni Bytyqi - është 90 ari dhe janë dy parcela.

Daradn Berisha - nëse i referohemi kësaj,mendova që do me bo plantacion me ndryshu veprimtarinë.

Avni Bytyqi - për shaka të volumit të madh të pikëve që kemi pas ,nuk kemi mujt me pru ma herët.

Urim Suka - shoh që raporti është bo në qershor dhe jemi shumë vonë.A kemi të drejtë ligjore rreth kësaj vonese? Këtu paska pas një ankesë.Për çfarë ankese bëhet fjalë dhe pse është refuzu?

Avni Bytyqi - komisioni i formuar prej Kuvendit prej tre anëtarëve e ka shqyrtu ankesën dhe ka vlerësuar që ankesa nuk i ka plotësuar kushtet dhe kriteret për tu aprovu dhe e ka refuzu.

Urim Suka - unë dashta me ditë një koncept pak ma të thellë se kaq.P.sh komisioni ia ka refuzu kërkesën,por unë mendoj që ai ka të drejtë me ndjekë edhe procedura tjera.

Avni Bytyqi - operatori ka të drejtë me ngrit kontest gjyqësor në gjykatën administrative,mirëpo është një dispozitë ligjore që ligji e thotë:nëse dikush ankohet ndaj një vendimi me procedurë administrative,padia nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Urim Suka - ne jemi për mu zhvillu zona industriale nese të gjitha janë në rregull.

Liridon Fanadaj - a ka vazhdu ky komision edhe pas pezullimit të punës?

Avni Bytyqi - raporti i komisionit që ka shqyrtu ofertat, ka ardh në zyre të Kryetarit me 11.06.2021,dhe ka ardh në aspektin ligjor në rregull.Ne e kemi procedu për KPF,kemi mbajt takimin,janë shpall zgjedhjet dhe ne e kemi pezullu procedurën.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim - plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për emërimin e komisionit për ndarjen e mirënjohjeve për “13 Qershorin”;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë se komisioni do formohet prej 7 anëtarëve dhe madati i komisionit do të jetë aq sa mandati i Asamblesë.

Dardan Berisha - a do të jenë gjithë anëtarët nga Kuvendi?

Avni Bytyqi - komisioni do të jetë prej 7 anëtarëve,ku do jenë 5 nga Kuvendi dhe dy jasht Kuvendit.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë se komision do jetë prej 7 anëtarëve ,ku do jenë 4 nga Kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe një vje nga vendbanimi ku bëhet përzgjedhja e këshillit lokal të atij vendi.

Urim Suka - më vje mirë që e keni marrë për bazë kërkesën që bana në Aamblenë e kaluar.E shoh si vendim të vonuar,sepse tash edhe kur formohet shkon kogja procedurë e gjatë deri sa të formohen

këshillat.Ne e mbështesim si ide dhe kërkojmë që ata që zgjidhen ta përfaqësojnë si duhet dhe ti zgjedhin këshillat lokale sipas rregullores në fuqi.

Dardan Berisha - realisht edhe në legjislaturën e kalume,pothuaj në dy vitet e para kam kërku,sepse prej paslufte nuk di që ka pas naj vendim për themelim të komisioneve të emërum për kryetar të fshatrave.Realisht kryetarët e fshatrave janë emru sipas rezultatit të partisë.

Unë këtu nuk pe shoh që këto komisione janë me pagesë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - kryetarët e fshatrave, a stimulohen nga ana e Komunës,përshkak se kanë angazhim.

Kryesuesi - vitin e kaluar kemi pas një takim me MAPL-në dhe unë kam kërku,sa është një pagë e asambleistit me marrë një meditje udhëheqësi i fshatit.Mirëpo ata nuk e pranun.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime shitesë rreth kësaj pyetje.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12176;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - unë e pata majt fjalën në Asamble dhe pata thanë që ky projekt-vendim është i destinuar për të dështuar.E kam ditë që dështon por se kam ditë që dështon mas një muaji.Edhe në KPF kam thënë që është gabim dhe ju kam drejtu Fadilit,dhe Fadili tha që nuk shkon kjo.Por ju e keni qu,veq me ju than punëtorëve që unë jam për juve,por VV janë atje.Por sido qoftë e dimë që është e paligjshme dhe e shfuqizojmë.

Kryesuesi - vullneti jonë ka qenë me ja realizu kërkesat punëtorëve të administratës.

Liridon Fandaj - si projekt-vendim për shfuqizim,duhet me pas një arsye.A naj ka refuzu, me pa si dokument.Në fillim të vitit është dasht me planifiku në buxhet.

Kryesuesi - është planifiku.

Liridon Fandaj - është planifiku te drekat zyrtare dhe për ata refuzohet.

Dardan Berisha - çdo vendim që po vje,po mundohi me politizu.

Urim Suka - është vendimi për shfuqizim dhe ti po thu që po boj politikë.

Dardan Berisha - pse se ki votu kundër,kur e ke ditë që ka mu shfuqizu.

Urim Suka - a m'ke dëgju çka kam thënë.Ti po don mu bo i mirë me punëtorët e Komunës ,a unë me dal për keq.

Bulëza Kuçi - a është arsyeja e shumës 3.5 euro dhe çfarë përgjigje kanë kthy?

Avni Bytyqi - jo nuk është kjo arsyeja.Ne për vitin 2022 sipas Fadilit dhe Kryetarit i kemi planifiku në buxhet.Mirëpo qeveria në ligj të buxhetit ,që asnjëherë deri më sot nuk e ka fut këtë dispozitë ligjore,ka thënë që nuk lejohet kompenzimi i personave individual apo edhe e kategorisë shujtje për punëtorë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - mars 2022;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 8. Informatë për rastet e përgjithshme të dhunës në familje;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe thotë që nënkryetarja do të na informojë në Asamble.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet

Pika 9 - shtesë

Avni Bytyqi - pak a shumë e analizova këtë çështje dhe u morr orientimi për me shku në Asamble. Unë mendoj që mos është më e arsyeshme që çështja e këtij komisioni të jetë, që ky komision ti ndihmojë qytetarëve gjatë procesit të konsultimit publik për draft dokumentin e hartës zonale të Komunës.

Saniqe Kuçi Rexhepaj - realisht nëse LDK e propozon Bulëzën ose Urimin, këta nuk janë njohës të hartave. Kjo ishte si shembull.

Avni Bytyqi - tash ka mjaftueshëm inxhinier, dhe mendoj secili me dërgu përfaqësuesin e vet në mënyrë që t'iu ndihmojë qytetarëve, dhe jo me monitoru drejtorinë e urbanizmit sepse kjo është pak e rëndë.

Saniqe Kuçi Rexhepaj - monitorimi nuk është në aspektin ligjor, monitorimi është me qenë edhe në pjesë si asamble, pra pjesë e procesit. P.sh në pikën finale ma shumë i dëgjojnë disa pakënaqësi të disa individëve, të qytetarëve që nuk iu ka aprovu kërkërkesa, sesa që e shohin në përmbajtje se si ka shku procesi. Pra, me qenë secili asambleist një hap më afër këtij procesi por jo me monitoru urbanizmin ose krejt ekipin që është prej krejt drejtorive.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 9 shtesë: Formimi i komisionit për ta përcjell procesin e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit të "Hartës Zonale të Komunës së Suharekës".

Unanimisht Miratohet

Pika 10 - shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 10 shtesë: Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alokimin e mjeteve brenda fondit burimor (38) Grandi Qeveritar - Rezervat për vitin fiskal 2022 nga projektet kapitale.

**4 për, 3 kundër
Miratohet**

Takimi përfundoi: 11:30

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj